



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 412/2 prot

Datë 28.02.2023

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME PRETENDIMET MBI KUALIFIKIMIN/SKUALIFIKIMIN E
OFERTUESVE TË TJERË DUKE REFERUAR VETËM KRITERET PËR TË CILAT
NGRIHEN PRETENDIME.

Objekti:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “SERVIS-AUTO 2000” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur,” me nr REF-52965-12-12-2022 me objekt: Loti 2 “*Riparim dhe mirëmbajtje automjetesh për Drejtorinë e Shërbimit të Peshkimit dhe Akuakulturës*” me afat të marrëveshjes kuadër 24 (njëzetë e katër) muaj, me fond limit 10,906,200 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 04.01.2023 nga autoriteti kontraktor Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “TENDENCE 3A” SHPK

Ankimues:

Operatori ekonomik “VILNIK MOTORS” SHPK
Adresa: Rruga “Kavajës”, Ndërtesa 2 katëshe, Kati 2, Km 6, Vaqarr, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara
Adresa: Blv “Dëshmorët e Kombit” Nd.1, 1001, Tiranë

Subjekte të Interesuara:

Operatori ekonomik “SERVIS-AUTO 2000” SHPK
Adresa: Rruga “Enriko Telini”, Nd. 15, H. 1, Tiranë

Operatori ekonomik “TENDENCE 3A” SHPK
Adresa: Rruga “29 Nëntori”, përballë ish doganës, Nr pasurie 12/100, Z.K 8310, Njësia Bashkiake nr.11, Tiranë

Në datën 27.02.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është paraqitur në mënyrë shkresore ankesa me nr. 412, protokolluar me datë 27.02.2023 e operatorit ekonomik “VILNIK MOTORS” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur,” me nr REF-52965-12-12-2022 me objekt: Loti 2 “**Riparim dhe mirëmbajtje automjetesh për Drejtorinë e Shërbimit të Peshkimit dhe Akuakulturës**” me afat të marrëveshjes kuadër 24 (njëzetë e katër) muaj, me fond limit 10,906,200 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 04.01.2023 nga autoriteti kontraktor Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomikë “SERVIS-AUTO 2000” SHPK dhe “TENDENCE 3A” SHPK.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “c” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) **pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.**”

-Komisioni I prokurimit Publik Publikon kriteret mbi te cilat ankimuesi pretendon se operatori ekonomik “SERVIS-AUTO 2000” SHPK nuk i plotëson:

7. **Operatori ekonomik ne lidhje me Agregatet / Pajisjet / Pjesët e këmbimit që do të përdoren gjatë realizimit të shërbimeve te percaktuara në shtojcën 6 Formulari i Shërbimave dhe Grafiku i ekzekutimit, duhet te plotësoje tabelën e mëposhtme duke specifikuar vendin e origjinës si dhe certifikimet te leshuara nga nje organ i akredituar.**

Agregatet / Pajisjet / Pjesët e këmbimit			Drejtorinë e Shërbimit të Peshkimit dhe Akuakulturës”
Nr.	Emërtimi i produktit	Vendi i origjinës	Certifikatë konformiteti ose cilësie CE/ekuivalent
1			
2			

Shënim 7.1:

Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin prane AK certifikatat e cdo produkti përpara publikimit të njoftimit të fıtuesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimimit.

Të dhënat që do të deklarohen, detyrimisht do ti paraqiten Autoritetit Kontraktor për të qenë pjesë e planit të zbatimit të kontratës.

Si dhe:

Ngrihen pretendime për mosjustifikim e ofertës anomalisht të ulët bazuar në nenin 93 të LPP-së nga ana e operatori tjetër ekonomik “SERVIS – AUTO 2000” SHPK, pjesmarrës në procedurë.

-Komisioni I prokurimit Publik Publikon kriteret mbi te cilat ankimuesi pretendon se operatori ekonomik “TENDENCE 3A” SHPK nuk i plotëson:

2.3 Kapaciteti teknik:

1. *Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 39% e vlerës së fondit limit të këtij loti. Këto shërbime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:*

- *Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimet e lëshuara nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose/dhe faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të e shërbimeve të realizuara.*

Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të e shërbimeve të realizuara.

7. *Operatori ekonomik ne lidhje me Agregatet / Pajisjet / Pjesët e këmbimit që do të përdoren gjatë realizimit të shërbimeve të percaktuara në shtojcën 6 Formulari i Shërbimeve dhe Grafiku i ekzekutimit, duhet të plotësojë tabelën e mëposhtme duke specifikuar vendin e origjinës si dhe certifikimet të leshuara nga nje organ i akredituar.*

<i>Agregatet / Pajisjet / Pjesët e këmbimit</i>			<i>Drejtorinë e Shërbimit të Peshkimit dhe Akuakulturës”</i>
<i>Nr.</i>	<i>Emërtimi i produktit</i>	<i>Vendi i origjinës</i>	<i>Certifikatë konformiteti ose cilësie CE/ekuivalent</i>
<i>1</i>			
<i>2</i>			

Shënim 7.1:

Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin prane AK certifikatat e cdo produkti përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimimit.

Të dhënat që do të deklarohen, detyrimisht do të paraqiten Autoritetit Kontraktor për të qenë pjesë e planit të zbatimit të kontratës.

Për më tepër operatori ekonomik kundërshton edhe vendkimin nr.241/3 prot., datë 20.02.2023 të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave në lidhje me vendimmarrjen e tij.

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 28.02.2023

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**Nënkryetar
Fiorent Zguro**

**Anëtar
Kreshnik Ternova**

**Anëtar
Anila Malaj**

**Kryetar
Jonaid Myzyri**